



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E SHTIMES



Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes

Npi – 01/60 datë: 13.03.2025

Kuvendi i Komunës së Shtimes ka miratuar Vendimin, Npi-01/288 datë: 30.08.2024 për formimin e Komisionit për vlerësimin e kërkesave lidhur me emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes, në këtë përbërje:

1. Zejnije Veliu.....përfaqësues nga pozita,
2. Kadri Emini.....përfaqësues nga pozita,
3. Lulzim Sahiti.....përfaqësues nga ekzekutivi,
4. Sami Januzi.....përfaqësues nga ekzekutivi,
5. Abdyll Hajredini.....përfaqësues nga komuniteti intelektual,
6. Naim Zeqiri.....përfaqësues nga komuniteti intelektual,
7. Mervete Hasani.....përfaqësues nga Shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së.

REKOMANDIME

PËR KUVENDIN NGA KËRKESAT PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE DHE SHESHEVE

1. z.Eshref Selmani - Raçak, Kërkesa Nr: 06-350/02-3300/23 datë 02.02.2023, ka kërkuar emërtimin e një rruge të re (në lagjen e tij), nuk e ka definuar propozimin e tij me ndonjë emër konkret. Arsyeja është dhënë se nuk kam adresë për adresimin e dokumentave. Kërkesa është individuale, pa ndonjë nënshkrim ose petition të banorëve.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 04.03.2025, shqyrtoi kërkesën Nr: 06-350/02-3300/23 datë 02.02.2023, të Eshref Selmanit – Raçak, dhe unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit MIRATIMIN e vendimit për emërtimin e kësaj rruge, me emrin “AHMET DELIA” nga Lista e Rezervë e Kuvendit Npi-01/81 të datës 05.04.2013.

2. z.Sait Sadiki, Rr. "Dragusha" Nr.24 Godanc i poshtëm, Kërkesa Nr: 06-350/02-30548/23 datë 17.11.2023, ka kërkuar emërtimin e një segmenti të rrugës "Dragusha" ku banojmë ne, me emrin "Epopeja e Marsit". Me arsyetimin se kjo rrugë i plotëson kriteret pasi që ka gjatësinë e mjaftueshme si dhe ka objekte banimi në këtë rrugë, dhe nuk ka ndonjë rrugë tjetër me këtë emër në komunën e Shtimes. Kërkesa është individuale dhe nuk ka ndonjë petition ose nënshkrime të banorëve të lagjes.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 18.03.2025, shqyrtoi kërkesën Nr: 06-350/02-30548/23, datë 17.11.2023, të Sait Sadiki - Godanc i poshtëm, dhe unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit MIRATIMIN e vendimit për emërtimin e kësaj rruge me emrin "EPOPEJA E MARSIT".

3. z.Nuhi Sylaj, Rr. "Anton Çeta" Nr.79 Shtime, Kërkesa Nr: 06-350/2-16621/24 datë 04.07.2024, ka kërkuar emërtimin e një rruge të re në lagjen e tyre me emrin "Salih Sylaj". Këtë rrugë ne trashëgimtarët e Salih Sylaj ja kemi dhuruar komunës së Shtimes pa kompensim me kushtin që rruga të emërtohet "Salih Sylaj". Për këtë si dëshmi ekziston kontrata e noterizuar, e cila gjendet në dosjen e Kadastrit. Në kërkesë janë të shënuar emrat e banorëve në këtë rrugë të gjithë familjar me një mbiemër Sylaj, si vijon: 1.Skender, 2.Nuhi, 3.Besim, 4.Driton, 5.Arben, 6.Paruk, 7.Arsim, 8.Blerim, 9.Adrian, 10.Gazmend dhe 11. Ilir Sylaj. Kërkesa është individuale,

nuk ka ndonjë peticion ose nënshkrime të banorëve. Rruga ka rreth 11 shtëpi, dhe lidhet vetëm në njërin anë, me rrugën "Anton Qeta".

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 04.03.2025, shqyrtoi kërkesën Nr:06-350/2-16621/24 datë 04.07.2024, të Nuhi Sylaj – Shtime, dhe unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit MIRATIMIN e vendimit për emërtimin e kësaj rruge, me emrin "SYLAJ".

4. z.Basri Mikullovc, Rr. "Qazim Mikullovc" Nr.12 Godanc i Poshtëm, Kërkesa Nr: 06-350/2-19260/24 datë 30.07.2024, ka kërkuar ndrrimin e emrit të rrugës "17 Shkurti" që të zëvendësohet me emrin e ri "Vllezërit Mikullovc". Kërkesa është Individuale, me një listë (kopje) të 140 emrave të banorëve të kësaj rruge siç ka thënë pala, me nënshkrime të pa verifikuara në 4 fletë A4. Lista nuk ka numra të Letërnjoftimeve, dhe nuk ka Titull se për fare arsye janë kërkuar nënshkrimet. Arsyeimi është dhënë si vijon: Pas ngritjes së Flamurit në Vlorë më 1912, gjatë rrugës duke u kthyer për në shtëpi, tre (3) Vllezërit Mikullovc me emrat: 1. Asllan Mikullovc, 2.Xhemajl Mikullovc, dhe 3.Ismajl Mikullovc, hasën në okupatorin Serb të cilët i malltretuan në mënyrën më mizore dhe në fund i likuiduan në Qafë të Duhies, ku edhe sot ndodhet lapidari. Ne kemi bërë kërkesë Nr.06-350-794 datë: 06.04.2013 edhe atëherë kur është bërë emërtimi i rrugëve, por nuk është marrë parasysh, prandaj kërkojmë që kjo kërkesë të rishqyrtohet edhe një herë, dhe të miratohet.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 06.12.2024, unanimisht, vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, REFUZIMIN e Kërkesës Nr: 06-350/2-19260/24 datë 30.07.2024, të Basri Mikullovcit, për ndrrimin e emrit të rrugës "17 Shkurti" me emrin "Vllezërit Mikullovc".

5. z.Salih Abazi, Godanc i Epërm, Kërkesa Nr: 06-350/02-19275/24 datë:30.07.2024, ka kërkuar emërtimin e rrugës duke filluar nga udhëkryqi e deri te shtëpia ime, Salih Abazi me numër 174 të emërtohet me emrin "Cen Meha". Rruga sipas informacioneve të marra nga Komisioni mund të lidhet ose prek edhe teritorin e Komunës së Lipjanit, për arsye se, afër gjindet rruga "Ismajl Qemajli" e emërtuar nga Komuna e Lipjanit, ku këto familje kanë qasje të drejtpërdrejt. Emri i propozuar i përket familjarëve të palës. Kërkesa është Individuale, ku i është bashkëngjitur edhe një listë me 23 nënshkrime të banorëve të kësaj lagje. Arsyeimi për emërtimin e rrugës është dhënë si nevojë e të gjithë banorëve për ta pas një adresë të saktë sepse po kemi probleme për adresimin e saktë të letrave postare dhe porosive ose gjërave të tjera që lidhen me adresën tonë.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 04.03.2025, shqyrtoi kërkesën Nr: 06-350/02-19275/24 datë:30.07.2024 të Salih Abazi – Godanc i epërm, dhe unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit MIRATIMIN e vendimit për emërtimin e segmenteve të rrugës me emrin "CENI".

6. z.Nazmi Ramadani, Vojnovc, Kërkesa Nr: 06-350/02-24551/24, datë 05.09.2024, ka kërkuar emërtimin e një rruge të re (në lagjën e tijë) me emrin "Idriz Ramadani" në fshatin Vojnovc. Në arsyetim është thënë se emri i propozuar i përket familjarëve të pales. "Idriz Ramadani" ka lindur më 21.02.1918, në fshatin Vojnovc, ky ishte një personalitet i respektuar nga banorët e fshatit, i cili u dallua si aktivist dhe udhëheqës i fshatit i cili shërbeu një kohë të gjatë si Kryetar i fshatit, me iniciative dhe aktivitete për përmirësimin e jetës së banorëve. Idrizi ka luajtur një rol të rëndësishëm në pajtimin e familjeve të përfshira në konflikte. Oda e Idrizit ishte një qendër ku pritë shumë njerëz që kërkuan ndihma dhe këshilla. Në këtë odë u organizuan shumë pajtime të familjeve jo vetëm nga ky fshat por edhe fshatrave përreth. Për shkak të këtijë angazhimi të

Idrizit nuk u pa me sy të mire nga rexhimi i atëhershëm kështu her-her ishte i ekspozuar ndaj presioneve të atij pushteti. Kërkesa është individuale dhe arsyetimi për emërtimin e rrugës është dhënë se në këtë rrugë ka më se 16 shtëpi banimi, dhe rruga është e asfaltuar nga Komuna e Shtimes.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 04.03.2025, shqyrtoi kërkesën Nr: 06-350/02-24551/24, datë 05.09.2024, të Nazmi Ramadani – Vojnovc, dhe me 4 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" vendosi që ti Rekomandon Kuvendit MIRATIMIN e vendimit për emërtimin e rrugës me emrin "IDRIZ RAMADANI".

7. z.Sevdair Haxhiu, Rr. "Ibrahim Kodra" Nr.18 Rashincë, Kërkesa Nr: 06-350/02-28896/24 datë:31.10.2024, ka kërkuar ndrrimin e emërimit të rrugës "Ibrahim Kodra" në fshatin Rashinc me emrin e ri "Zek Haxhiu". Emri i propozuar i përket familjarëve të palës. Kërkesa është individuale dhe nuk ka ndonjë peticion ose nënshkrime të banorëve të lagjes. Arsyetimi për emërtimin e kësaj rruge është dhënë se ky emër i propozuar është i familjes tonë, dhe ky vëlla na ka vdekur në vitin 1979 në moshën 24 vjeçare. Më tej pala ka shkruar se jemi të bindur se banorët e lagjes tonë nuk paraqesin ankes në rast të ndërrimit të emrit.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 06.12.2024, unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, REFUZIMIN e Kërkesës Nr:06-350/02-28896/24 datë: 31.10.2024, të Sevdair Haxhiu – Rashinc, për ndrrimin e emrit të rrugës "Ibrahim Kodra" me emrin e ri "Zekë Haxhiu".

8. z.Selami Rashiti, Petrovë, Kërkesa Nr: 06-350/02-30259/24 datë:19.11.2024, ka kërkuar emërtimin e një rruge të re me emrin e Veteranit "Zejnush Rashiti". Rruga gjendet te restorant "Lisi" e cila lidhet me rrugët "Skender Salihaj" dhe rrugën "Ahmet Shtimja". Emri i propozuar i përket familjarëve të palës. Kërkesa është individuale dhe nuk ka ndonjë peticion ose nënshkrime të banorëve të zonës. Arsyetimi për emërtimin e rrugës është dhënë se ky emër i propozuar është i familjes tonë, dhe Veterani tani i ndjerë "Zejnush Rashiti" ka dhënë kontributin e tij për shtet nga themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës e deri te çlirimi dhe pavarësia e Kosovës. Ka qenë pjeshtarë i UÇK-së dhe është themelues i pikës së Rancës së bashku me shokët e tij.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 18.12.2024, unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, REFUZIMIN e Kërkesës Nr:06-350/02-30259/24 datë: 19.11.2024, të Selami Rashiti - Petrovë me arsyetimin se rruga tani nuk është e hapur deri në fund dhe nuk i plotëson kriteret ligjore. Por në të ardhmen me plotësimin e kriterëve ligjore kjo rrugë mund të emërtohet.

9. z.Hyzer Gashi, Pjetërshticë, Kërkesa Nr: 06-350/02-30308/24 datë:20.11.2024, ka kërkuar emërtimin e një rruge të re me emrin "Idriz Ajet Gashi". Rruga gjendet në zonën kadastrale – Shtime, që lidhet me rrugën "Komandant Kumanova" dhe shkon deri te "Liqeni i Mjellmave" dhe fabrika e lëngjeve "Bion". Emri i propozuar i përket familjarëve të palës. Kërkesa është individuale dhe nuk ka ndonjë peticion ose nënshkrime të banorëve të zonës. Për emrin e propozuar pala ka ofruar një biografi të shkurtë të shkruar të marrë nga libri i Prof.dr. Emin Kabashi me titull "Lufta Kundër Robërisë dhe Historia" (Idriz Ajet Gashi – Jeta dhe Vepra).

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 18.02.2025, unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, REFUZIMIN e Kërkesës Nr:06-350/02-30308/24 datë: 20.11.2024, të Hyzer Gashi – Pjetërshticë.

10. z.Alban Rashiti, Rr. "Fadil Rashiti" Nr.47 Petrovë, Kërkesa Nr: 06-350/02-30686/24 datë:26.11.2024, ka kërkuar ndërrimin e emrit të sheshit "Shaban Jashari" në Petrovë me emrat alternativ të propozuar "Sheshi i Dëshmorëve" ose "Dëshmorët e Petrovës", ose edhe të merret ndonjë ide tjetër. Kërkesa është individuale dhe nuk ka ndonjë peticion ose nënshkrime të banorëve të zonës. Pala nuk ka ofruar ndonjë arsyetim për ndërrimin e këtij emri.
- REKOMANDIM:** Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 18.12.2024, unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, REFUZIMIN e Kërkesës Nr:06-350/02-30686/24 datë:26.11.2024, të Alban Rashiti – Petrovë, për ndërrimin e emrit të sheshit "Shaban Jashari" në Petrovë me emrat alternativ të propozuar "Sheshi i Dëshmorëve" ose "Dëshmorët e Petrovës", mbetet emri i vjetër "Shaban Jashari".
11. z.Bekim Mehmeti, Godanc i Epërm, Kërkesa Nr: 06-350/02-30716/24 datë:27.11.2024, ka kërkuar ndërrimin e emrit të rrugës "Kadolli" në Godanc të epërm, me emrin e ri të Martirit "Enver Mehmeti". Bashkë me kërkesën pala ka ofruar edhe këto shkresa si vijon: 1. Tri fletë A4, kopje të listës së nënshkrimeve prej 63 banorëve të lagjes. 2. Kopjen e kërkesës Nr.01/016/3941 të datës 10.02.2014 për emërtimin e kësaj rruge me merin e Martirit "Bekim Mehmeti", kërkesë e atëhershme e jona e paraqitur në Kuvendin e Komunës së Shtimes, e cila nuk është marrë parasysh. 3. Kopjen e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/70 të datës 19.03.2014 për refuzimin e kërkesës tonë Nr.01/016/3941, dt.10.02.20214.
- Arsyetimi për ndërrimin e emrit të rrugës është dhënë si vijon: Fillimisht shprehim paknaqësinë tonë me emërtimin aktual të këtij segmenti të rrugës sonë, me emrin "Kadolli" e jo me emrin e Martirit "Enver Mehmeti" ku edhe si lagje është përkrahur nga 63 banorë të nënshkruar nga 72 sa gravitojnë në këtë lagje. Emri "Kadolli" neve si lagje asgjë nuk na përfaqëson, përveç se është emri i një firme të një familje, e cila gjithmonë ka qenë e përfshirë në vendimmarrje dhe si e tillë ka pasur mundësi të ketë ndikim në emërtimin e kësaj rruge. Martiri "Enver Mehmeti" i ndjerë, anëtar i familjes tonë duke qenë vetëm 15 vjeçar u ekzekutua nga forcat Serbe gjatë kohës së Luftës Çlirimtare 1998-99. Ne mendojmë se kjo do duhej të ishte prioritare për komisionin për emërtimin e rrugëve, si dhe komunën e Shtimes, duke i ditur vlerat e një të riu duke qenë Martir i luftës në Komunën tonë.
- REKOMANDIM:** Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 04.03.2025, shqyrtoi kërkesën Nr: 06-350/02-30716/24 datë:27.11.2024, të Bekim Mehmeti - Godanc i Epërm, dhe unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e vendimit, për ndërrimin e emrit të rrugës "Kadolli" me emrin e ri të Martirit "ENVER MEHMETI".
12. z.Enver Ramadani -Vojnoc, Kërkesa Nr: 06-350/02-3323/25 datë 07.02.2025, ka kërkuar ndërrimin e emrit të rrugës "Shabani" me emrin e ri "Shehri" në fshatin Vojnoc, me arsyetimin se me emrin që ka rruga tani, banorët e lagjës nuk pajtohen. Kërkesa është individuale. Kërkesës i ka bashkangjitur një listë me 12 nënshkrime të banorëve të lagjës. Nuk ka asnjë arsyetim se pse dëshirojnë këtë rrugë ta emërtojnë me këtë emër.
- REKOMANDIM:** Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 18.12.2024, unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, REFUZIMIN e Kërkesës Nr:06-350/02-3323/25 datë 07.02.2025, të Enver Ramadani për ndërrimin e emrit të rrugës "Shabani" në fshatin Vojnoc me emrin e ri "Shehri".
13. z.Bajram Ilazi - Shtime, Kërkesa Nr: 06-350/02-3355/25 datë 07.02.2025, ka kërkuar që një rrugë në Komunën e Shtimes të emërtohet me emrin "Shefki Osmani". I ndjeri Shefki Osmani

ishite asambleist i Komunës së Shtimes, ka ushtruar profesionin e mësimdhënësit deri në pensionimin e tij. Ishte aktivist për avancimin e të drejtave për komunitetin ashkalinjë.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 04.03.2025, shqyrtoi kërkesën Nr: 06-350/02-3355/25 datë 07.02.2025, të Bajram Ilazi – Shtime, dhe unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit MIRATIMIN e vendimit për emërtimin e segmentit në fund të rrugës “Hysiqi” në anën e majtë, me emrin “SHEFKI OSMANI”.

14. z.Shaban Krasniqi - Gllavicë, Kërkesa Nr:06-350/02-3646/25 datë 11.02.2025, ka kërkuar ndërrimin e emrit të rrugës “Galica” në fshatin Gllavicë dhe të zëvendësohet me emrin “Dëshmori Nazmi Guri”. Kërkesa është individuale, me një listë prej 115 emrave të banorëve të kësaj rruge, me numra të letërnjoftimeve. Arsytimi është dhënë se ky emër i bën nderë fshatit dhe Komunës, duke dhënë kontributin e tij në çlirimin e vendit.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 04.03.2025, shqyrtoi kërkesën Nr:06-350/02-3646/25 datë 11.02.2025 të Shaban Krasniqit – Gllavicë, dhe unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, MIRATIMIN e vendimit për ndërrimin e emrit të rrugës “Galica” në fshatin Gllavicë me emrin e ri të Dëshmorit “NAZMI GURI”.

15. z.Rahman Selmani - Shtime, Kërkesa Nr: 06-350/02-3768/25 datë 12.02.2025, ka kërkuar ndërrimin e emrit të rrugës “Nazim Kokollari” që të riemrohet me emrin “Shefki Selmani” me arsyen se kur është emërtuar kjo rrugë, nuk janë konsultuar fare banorët e kësaj lagje për këtë emërtim. Kërkesa është individuale, ka një peticion me 7 nënshkrime të familjarëve, me numër të letërnjoftimit dhe mbanë titullin e banorëve të lagjës. Në këtë lagje janë 7 familje dhe të gjithë janë familjarë të Shefki Selmanit, tani të ndjerë i cili ka qenë njëri nga punëtorët më të vjetër të Institucionit Shëndetësor në Komunën e Shtimes, (QKMF) dhe i cili për shkak të punës së tijë fisnike dhe të palodhur ka gëzuar autoritet jo vetëm në mesin e bashkëpunëtorëve por edhe shumë më gjerë.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 18.02.2025, unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, REFUZIMIN e Kërkesës Nr:06-350/02-3768/25 datë 12.02.2025, të Rahman Selmanit – Shtime, për ndërrimin e emrit të rrugës “Nazim Kokollari” në Shtime me emrin e ri “Shefki Selmani”.

16. z.Bekim Seferi – Lagje e Pajtimit, Kërkesa Nr:06-350/02-4783/25 datë 27.02.2025, ka kërkuar emërtimin e një Segmenti të rrugës “Anton Çeta” në dalje të Shtimes me emrin “Muhamet Seferi”. Si arsyetim ka dhënë faktin se i ndjeri Muhamet Seferi ka qenë një kohë të gjatë Sekretar i Xhamisë së madhe në Shtime dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në aktivitetet shoqërore dhe fetare. Po ashtu ka qenë i angazhuar në shumë aksione humanitare dhe e ka ndihmuar komunitetin me ndihma në momentet më të vështira. Ka kontribuar në ruajtjen e traditave dhe forcimin e bashkëpunimit mes njerëzve. Ishte figurë e respektueshme për të gjithë. Ky segment ka vetëm tri shtëpi dhe që të trija këto shtëpi janë djem, nipa e mbesa të Haxhi Muhametit.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 13.03.2025, unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit REFUZIMIN e Kërkesës Nr:06-350/02-4783/25 datë 27.02.2025, të Bekim Seferit – Lagje e Pajtimit.

17. z.Valon Bajrami – Lagje e Pajtimit, Kërkesa Nr:02-070/05-5893/25 datë 13.03.2025, ka kërkuar në emër të familjarëve të Basri Bajramit që të emërtohet një nga rrugët në komunën e Shtimes me emrin e “Basri Bajrami” në shenjë nderimi dhe vlerësimi për kontributin e tijë të

jashtëzakonshëm në zhvillimin e komunës në shërbim të Shtetit të Kosovës. Basri Bajrami u lind më 21.05.1960 në fshatin Reçak, ku u rrit dhe u edukua në një familje të mesme fshatare bashkë me tri motra dhe pesë vllazër. Pas përfundimit të shkollës fillore, të mesme dhe fakultetit Ekonomik, në vitin 1988 zgjedhet Kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Komunës së Shtimes së atëhershme të sapo formuar në moshën 28 vjeqare. Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të mbajtura në Nëntor 1989, Basriu u zgjodh Deleat i Kuvendit, ku edhe tregoi angazhim për jetësimin e ndryshimeve që kërkoheshin në atë kohë, ishte përkrahës dhe pjesëmarrës dhe nënshkrues i mbajtjes së mbledhjes së Kuvendit të Kosovës më 2 Korrik 1990. Ku më pastaj të gjithë delegatët e Kuvendit të Kosovës u përdoqën nga rexhimi i Serbis, kështu që së bashku me delegatët tjerë u detyruan që ta lëshojnë Kosovën pas datës 7 Shtator 1990. Më datën 2 Korrik 2010 Basriut i ndahet "Medalja e Artë e Pavarësisë" në shenjë të kontributit ku më 2 Korrik 1990 ishte pjesëmarrës në shpalljen deklarates Kushtetuese për Pavarësinë e Kosovës. Kështu që ne si familjarë besojmë se ai e meriton të nderohet me emërtimin e një rruge.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 13.03.2025, shqyrtoi kërkesën Nr:02-070/05-5893/25 datë 13.03.2025, të Valon Bajramit – Lagje e Pajtimit, dhe unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit MIRATIMIN e vendimit për emërtimin e unazës së vogël në Shtime me emrin "BASRI BAJRAMI".

18. z.Hyzer Neziraj – Mollopolc, Kërkesa Nr:02-070/05-5976/25 datë 14.03.2025, ka kërkuar emërtimin e rrugës e cila ndahet të Xhamia e fshatit e cila ka rreth 500 metra gjatësi, që të emërtohet me emrin "Qershori". Kjo rrugë i lidhë rrugët "Hamëz Jashari me rrugën "Islam Neziraj". Arsyetimi është se Dëshmori i UÇK-së, Islam Neziraj, vëllau ynë, gjatë luftës ka mbajtur nofkën "Qershori". Si dhe duke pas parasysh faktin se e tërë familja e dëshmorit jeton në këtë rrugë, dhe në Komunën e Shtimes nuk ka ndonjë rrugë me këtë emërtim. Po ashtu edhe banorët e tjerë të lagjes janë pajtuar me këtë propozim.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 18.03.2025, shqyrtoi kërkesën Nr:02-070/05-5976/25 datë 14.03.2025, të Hyzer Neziraj – Mollopolc, dhe unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit MIRATIMIN e vendimit për emërtimin e kësaj rruge me emrin "QERSHORI 99".

19. z.Endrit Emini – Davidovc, Kërkesa Nr:06-350/02-6076/25 datë 17.03.2025, ka kërkuar emërtimin e rrugës nga udhëkryqi të Xhamia e fshatit Davidovc në drejtim të familjeve Emini, me emrin "Zejn Emini", në shenjë nderimi për familjen Emini. Arsyetimi është se "Zejnë Emini" i njohur nga banorët si "Haxhi Zejna" ka qenë një luftëtarë i guximshëm që veproi në kufirin mes Kosovës dhe Serbisë, më konkretisht në zonën e Prapashticës (Lufta e dytë Botërore). Ai ka luftuar atje së bashku me dy shokët e tij, Imer Abazi dhe Zeq Zeqiri. Gjatë luftimeve ishte plagosur rëndë me shtatë plagë, mirpo edhe përkundër plagëve ka vazhduar luftën deri sa edhe pas një kohe ka ndërruar jetë si pasojë e plagëve të marra. Kontributi i tij për atdheun është i njohur për banorët e Davidovcit por edhe më gjerë.

REKOMANDIM: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 18.03.2025, shqyrtoi kërkesën Nr:06-350/02-6076/25 datë 17.03.2025, të Endrit Emini – Davidovc, dhe unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit MIRATIMIN e vendimit për emërtimin e kësaj rruge me emrin "ZEJN EMINI".

KONKLUZION:

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, përgjatë punës që ka bërë që nga mbledhja e parë e Komisionit e mbajtur më 18.10.2024 e deri në mbledhjen e gjashtë të mbajtur më 13.03.2025, përveq shqyrtimit të kërkesave, ka identifikuar se:

1. Në Komunën e Shtimes ka më shumë se 200 rrugë ose segmente rrugore që kanë nevojë për emërtimin e tyre.
2. Komisioni ka identifikuar se ka disa rrugë të cilat janë të emërtuara me vendimin e Kuvendit Npi-01/80 datë 05.04.2013, mirëpo nuk janë të inkuorpuara në Sistemin Elektronik të Adresave. Si dhe ka disa rrugë që janë në Sistemin Elektronik të Adresave por që nuk ekzistojnë fare në Vendimin e Kuvendit, Npi-01/80 datë 05.04.2013, e as në ndonjë vendim tjetër të Kuvendit.
3. **REKOMANDIM:** Rrugët që nuk janë në Sistemin Elektronik të Adresave e të cilat janë në Vendim të Kuvendit, duhet të futen në Sistemin Elektronik të Adresave. Te rasti tjetër të gjitha rrugët të cilat janë në Sistemin Elektronik të Adresave dhe nuk janë në vendimet e Kuvendit duhet të shlyhen nga Sistemi Elektronik i Adresave dhe gjendja të kthehet në pikën ku kemi harmonizim të plotë në mes të Vendimit të Kuvendit dhe Sistemit Elektronik të Adresave.



Kryesuesja e Komisionit

Zejanije Velu

(Signature)